



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0280

OSHP: 2024/0289

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga Vedat Poterqoi – Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “2A Group SH.P.K.” dhe ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “HIDRO PROJECT SH.P.K.”, ushtruar kundër vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Drenas” me nr. të prokurimit: "206-23-6378-5-1-2", iniciuar nga MINISTRIA E SHËNDETËSISË, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 10.07.2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**, si të pjesërisht të bazuara ankesat e “2A Group SH.P.K.” me nr. 2024/0280 e datës 29.03.2024, si dhe ankesa e OE “HIDRO PROJECT SH.P.K.” me nr. 2024/0289 e datës 02.04.2024, kurse vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Drenas” me nr. të prokurimit: "206-23-6378-5-1-2", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –MINISTRIA E SHËNDETËSISË, **mbetet në fuqi.**

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.06.2023 **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Ndërtimi i QKMF në Drenas**” me nr. të prokurimit: "206-23-6378-5-1-2". Ndërsa me datë 15.03.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,976,487.83 €.

Me 20.03.2024 OE “2A Group SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 21.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datë 20.03.2024 po ashtu edhe OE “HIDRO PROJECT SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Anulim të Autoritetit Kontraktues. AK të njëjtën kërkesë me datën 22.03.2024 e ka refuzuar.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues “2A Group SH.P.K.” ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2024/0280 e datës 29.03.2024, si dhe OE ankues “HIDRO PROJECT SH.P.K.” ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0289 të datës 02.04.2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas

nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2024/0280 dhe ankesa nr. 2024/0289 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit “2A Group SH.P.K.”

Bazuar në interpretimin e KRPP-së të datës 14.10.2022 dhe datës 22.06.2023, kërkesa për çertifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, siç është ISO 9001, është një kërkesë e përshtatshme profesionale. Kjo do të thotë se çdo anëtar i grupit të operatorëve ekonomikë duhet të jetë i pajisur me një çertifikatë të tillë. Kjo kërkesë nuk lidhet me gjendjen ekonomike dhe financiare apo me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, por me cilësinë e menaxhimit të kompanisë. Prandaj, vendimi i zyrtarit përgjegjës për prokurimin është në përputhje me interpretimin e KRPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik. AK i konsideron si të pabazuara pretendimet e OE ankues.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit “HIDRO PROJECT SH.P.K.”

Pretendimet ankimore paraqitura janë rishqyrtuar dhe konfirmuar si të pa bazuar në faktet dhe kriteret e përcaktuara:

Pretendimi i parë ankimor për arsyet e eliminimit nuk ka bazë, pasi marrëveshja me Benita Company SHPK është për projektin specifik dhe nuk ka gabime teknike. Pretendimi i dytë lidhur me deklaratat e mbështetjes bankare është i pa bazuar, pasi një mbështetje e pakushtëzuar nuk ishte e kërkuar nga NJK dhe DT, dhe ofertat janë vlerësuar si të pranueshme nga OSHP. Pretendimi i tretë për ISO çertifikatat është konfirmuar, pasi konsorciumi ka plotësuar kërkesat për çertifikime dhe dokumentacionin ka qenë i plotë në datën e duhur. Pretendimi i katërt lidhur me listën e kontratave të realizuara është i pa bazuar, pasi lista përmban të gjitha të dhënat e

kërkuara pavarësisht se nuk përputhet me shabllonin e përcaktuar. Pretendimi i pestë për stafin e punëtoreve është i pa bazuar, pasi kontratat kanë pasur vlefshmëri të mjaftueshme dhe procesi është zgjatur për shkak të ankesave, pa penalizuar ofertuesin në vlerësimin aktual. Pretendimi i gjashtë për stafin e inxhinierëve është i pa bazuar, pasi kompania ka plotësuar kriteret për profilin inxhinierik të kërkuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues 2A Group SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Sqarim hyrës : Grupi i Operatorëve Ekonomik, i përbërë nga 2A Group SH.P.K dhe 2T SH.P.K, ka paraqitur ankesë për vendimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga data 15.03.2024. Ankesa është bazuar në pretendimet për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke përfshirë nenin 68 paragrafi 4 për Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 paragrafi 8 për Aftësinë Teknike dhe/ose Profesionale, si dhe nenin 71 paragrafi 4 për Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik.

Në ankes gjithashtu është shprehur shqetësimin për mosrespektimin e nenit 7 të LPP-së, për Barazinë në Trajtim Jo-Diskriminim, duke pretenduar se vendimi i Autoritetit Kontraktues është i anëshëm dhe i papranueshëm. Grupi i Operatorëve Ekonomik ka argumentuar se vendimi është bazuar në një interpretim të paqartë të KRPP-së dhe nuk ka pasur në konsideratë faktet e paraqitura nga ana e tyre. OE kanë theksuar se certifikatat ISO janë ofruar për një anëtar të grupit, 2T SH.P.K dega në Kosovë, dhe ky veprim është në përputhje me interpretimin nr. 18 të KRPP-së, duke shpjeguar që dega në Kosovë është një degë e shoqërisë së huaj tregtare, 2T SH.P.K Tiranë, dhe nuk është person juridik i ndarë nga shoqëria që e ka themeluar atë.

Në fund, OE kërkojnë që Organizata për Shtetësi të Hapësirës së Prokurimit të shqyrtojë ankesën dhe të kthejë lëndën për rivlersim, duke konsideruar ofertën e tyre si të përgjegjshme në përputhje me ligj. Pretendimi i OE ankues : OE ankues pretendon se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka shkelë LPP-në përkatësisht nenet : 7, 68, 69, 71 si dhe dispozitat e ligjit nr,06/L-016 mbi shoqërit tregtare, neni 35 par.6. për faktin se ka eliminuar të njëjtit sepse ISO standardin e ka sjellë nga kompania e Tiranës, përderisa thirret në interpretimin e KRPP-së nr 18 e datës 22.11.2024, sepse nuk mund ta diskualifikoj OE ankuesin për dokumentet e sjellura nga kompania e njëjtë, jashtë Kosovës, dhe se të njëjtit pretendojnë se plotësojnë kërkesën si grup në tërsi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues HIDRO PROJECT SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Në kuadër të procesit të prokurimit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Drenas, grupi ynë Hidro Project Shpk & Engrup Shpk është eliminuar nga faza e mëtejshme për arsye që ne i konsiderojmë të pabaza dhe të padrejta.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka deklaruar se nuk kemi ofruar të gjitha pajisjet e kërkuara me dokumentacion në emër të Hidro Project, përveç një eskavatori, një kamioni dhe një ngarkuese. Pajisjet e tjera janë ofruar me dokumentacion nga Benita Company, por pa marrëveshje për shfrytëzimin e tyre, përveç një marrëveshjeje për furnizim me beton.

Ne kemi dorëzuar një listë të plotë të mjeteve dhe pajisjeve sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Këto pajisje janë në pronësi të Hidro Project dhe Engrup. Marrëveshja me Benita Company për furnizim me beton është përfshirë si gabim teknik dhe nuk ishte kusht në dosjen e tenderit. Për këtë arsye, përfshirja e saj nuk duhet të ndikojë në eliminimin tonë.

AK ka bërë shkelje të dispozitave të përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave sipas nenit 56 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe njëanshme, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Për grupin e operatorëve ekonomikë Termomontimi NN, 100% Design Shpk, Haxha Kom Shpk, Rexha, kemi vërejtur se letra e referencës nga banka nuk garanton financimin e projektit, duke lënë mundësinë që banka të shqyrtojë financimin vetëm në rast të shpalljes së fituesit. Lista e stafit nuk plotëson kriteret për 40 punëtorë teknikë, me kontrata të skaduar dhe me paga nën minimalen e lejuar.

Për grupin e operatorëve ekonomikë AC Ing Shpk, Top Projekt Shpk, A Con Shpk, Decon Shpk, ISO çertifikatat janë dorëzuar vetëm për dy nga katër kompanitë në grup, që bie ndesh me kërkesën ligjore që të gjithë anëtarët të dorëzojnë çertifikatat përkatëse. Dokumentacioni financiar nuk garanton kapitalin e nevojshëm për projektin dhe lista e stafit nuk përmbush kriteret e kërkuara për punëtorët teknikë dhe të çertifikuar.

Për BM Group Shpk, letra e referencës nga banka nuk siguron mbështetje financiare të garantuar për projektin dhe lista e stafit dhe kontratat nuk përmbushin kushtet e kërkuara, me kontrata të

skaduara dhe paga nën minimalen e lejuar.

Duke marrë parasysh argumentet dhe dëshmitë e paraqitura, kërkohet që vendimi për eliminimin tonë të rishikohet dhe të bëhet një ekzaminim i plotë dhe i paanshëm i dokumentacionit të dorëzuar nga të gjithë operatorët ekonomikë. Ne besojmë se plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara dhe që eliminimi ynë është bërë në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 280/24 dhe 289/24 ndërsa me datë 22.04.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertes shqyrtuese.

Lidhur me ankesën nr. 280/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “*ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit*”.

Konstatimet e ekspertes shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 280/24 të operatorit ekonomik 2A Group SH.P.K.

“Lidhur me pretendimin e OE ankues kundër arsye së eliminimit sqaron se, sipas rregullores për prokurim publik nenit 26.6, dhe neni 70 i LPP-së çertifikatat e cilësisë, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet, kurse OE ankues thirret në interpretimin e KRPP-së, i cili saktëson përmbushjen e kërkesave lidhur me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, pra neni 70 i LPP-së nuk hyn si grup në tërësi përkatësisht çertifikatat e cilësisë, andaj **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar**, për faktin se pas kërkesës për sqarim nga AK, i njëjti sjellë ISO standardet e kompanisë në Tiranë dhe jo kompanisë 2T dega në Kosovë, pra OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën nr.4 të dokumentit standard të para kualifikimit.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa Operatori ekonomik

nuk është deklaruar.

Lidhur me ankesën nr. 289/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “*ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit*”.

Konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 289/24 të operatorit ekonomik HIDRO PROJECT SH.P.K.

Ekspertja shqyrtuese, pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga Hidro Project Shpk & Engrup Shpk në platformën E-prokurim, sqaroi se, ndonëse në ofertën e tyre gjendet lista e pajisjeve, OE nuk ka ofruar dëshmi për marrëveshjen për shfrytëzim të pajisjeve të cilat nuk i ka në pronësi. Ekspertja shqyrtuese vlerësoi se, nëse OE do ta kishte marrëveshjen para datës së hapjes së ofertave dhe ajo do të ishte e noterizuar, duhej ta kishte paraqitur si dëshmi shtesë. Kësisoj, pretendimi i OE nuk gjendet i bazuar.

OE ankuesi ka parashtruar gjithashtu pretendime ankimore për katër operatorët ekonomikë të tjerë të kualifikuar. Për të gjitha pretendimet e OE ankuesit ndaj këtyre grupeve, ekspertja shqyrtuese dha përgjigje të njëjtë. Sipas saj, pretendimi lidhur me letër përkrahjen nga bankat është i pabazuar, pasi deklaratat mbështetëse janë të pranueshme sipas kërkesave të AK. Bankat ofrojnë referenca bazuar në qarkullimin, hipotekën dhe historinë bankare të klientit. Vendimi i panelit shqyrtues, datë 10.08.2023, mbështet këtë pikëpamje.

Pretendimi i OE lidhur me kontratat e punës gjithashtu u vlerësua i pabazuar. Ekspertja sqaroi se, meqenëse kontratat kanë qenë valide gjatë hapjes së aplikimeve, operatorët ekonomikë nuk mund të eliminohen nëse kontratat skadojnë gjatë procedurave të vlerësimit. Gjithashtu, pretendimi lidhur me mungesën e vulës në kontratën e punës me Termomontimi Shpk u cilësua i pabazuar, pasi në dosjen e tenderit nuk ishte kërkuar vendosja e vulës.

Në lidhje me ISO standardet për OE AC-Ing SHPK, pas kërkesës për sqarim nga AK, operatori i kishte sjellë ISO standardet e kërkuara. Pretendimi për mungesë të listës së projekteve u vlerësua gjithashtu i pabazuar, pasi lista e projekteve gjendej në ofertë dhe nuk përbënte ndryshim material. Sa i përket kontratave për marrjen me qira të pajisjeve nga AC-Ing Shpk, ekspertja shqyrtuese theksoi se AK nuk kishte precizuar ndonjë kërkesë tjetër përveç marrëveshjes.

Në përfundim, ekspertja shqyrtuese konstatoi se Hidro Project Shpk nuk arriti të argumentojë me fakte përgjegjshmërinë e tij lidhur me marrëveshjen për shfrytëzim të pajisjeve, dhe pretendimet e ngritura kundër operatorëve të tjerë të kualifikuar nuk qëndrojnë. Prandaj, rekomandoi që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa Operatorët ekonomik nuk janë pajtuar.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përdërisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave sipas ankesave të dorëzuar me numër protokollit Nr. 2024/0280 dhe 2024/0289 sqaron se konstatimet në raportin e ekspertës shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues **2A Group SH.P.K.**, dhe **HIDRO PROJECT SH.P.K.**, i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertës shqyrtuese, pa nevojë që të njëjta të përsëriten sërish, pasi që raporti i ekspertizës është edhe pjesë e këtij vendimi. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorëve ankues të përmendur si më sipër janë të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË** lidhur me aktivitetin e prokurimit me **“Ndërtimi i QKMF në Drenas”** me nr. të prokurimit: "206-23-6378-5-1-2".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat

relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Arsyeja e vetme që ky panel shqyrtues i kualifikon këto dy ankesa si pjesërisht të bazuar edhe pse vendos që ta lërë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues, është se këto arsye të eliminimit nuk janë paraqitur në vlerësimin e parë të ofertave dhe njoftimin mbi vendimin e AK të datës 23.10.2023, por janë paqitur tek në fazën e ri-vlerësimit dhe në vendimin e dytë të datës 15.03.2024, kështu që rezulton se komisioni i parë i vlerësimit të ofertave nuk ka qenë profesional dhe ka bërë që ky aktivitet për shkak mos profesionalizmit të tyre të prolongohet deri në këtë fazë dhe OE të shfaqin përmes ankesave paknaqësit rreth vlerësimit të ofertave të tyre.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - 2A Group SH.P.K., HIDRO PROJECT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: